

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6483
E martë, 7 dhjetor 2021
çmimi 0.40 €

Stano: Prishtina dhe Beogradi nuk kanë gatishmëri për dialog

FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

VAZHDON PROCESI GJYQËSOR NË HAGË NDAJ HYSNI GUCATIT DHE NASIM HARADINAJT

FAQE 4-5

GUCATI: DO TË JEPJA DORËHEQJE NËSE DO TË RRIDHTE NDONJË DOKUMENT NGA ZYRA IME



Kryetari i Organizatës i Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK), Hysni Gucati, ka hedhur poshtë pretendimet e Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS) ndaj tij. Në dëshminë e tij para trupit gjykues të Dhomave të Specializuara në Hagë, ai ka fajësuar ZPS-në për nxjerrjen e dokumenteve në publik. Sipas tij, me këto veprime ata e kanë vënë në kurth atë dhe pjesëtarët e tjerë të UÇK-së. Në adresimin e tij, Gucati ka thënë do të jepte dorëheqje nëse do të rridhte ndonjë dokument nga zyra e tij në OVLUÇK

AKTUALE



SHKENCËTARJA PARALAJMËRON PËR NJË PANDEMI TË RE "MË VDEKJEPRURËSE" F. 2

VRASJA NË GLLOGJAN TË DEÇANIT, KURTI: HETUESIT MË TË MIRË TË VENDIT PO MERRN ME KËTË RAST F. 6

VLERËSOHET PUNA E STREHIMOREVE PËR LUFTIMIN E DHUNËS NË FAMILJE F. 7

EKONOMI



PARAQITET STRATEGJIA PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL 2021-2027 F. 8

DËSHTON EMËRIMI I BORDIT TË RI TË OSHP-së F. 8

SPORT



NË GRUPIN B, TRI KLUBE KËRKOJNË KUALIFIKIMIN F.12

Liderët e institucioneve të Kosovës nderojnë ish-senatorin Dole

FAQE 3



MJEKËT PARALAJMËROJNË GREVË, I JAPIN ULTIMATUM KURTIT DERI MË 15 DHJETOR

FAQE 7

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
E-mail: renova@mt.net.mk
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302.
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Shkencëtarja paralajmëron për një pandemi të re “më vdekjeprurëse”

LONDËR, 6 DHJETOR - Zhvilluesja kryesore e vaksinës kundër koronavirusit të Oxford/AstraZeneca ka paralajmëruar se pandemia e ardhshme mund të jetë “më vdekjeprurëse”, duke bërë thirrje që të bëhen parapërgatitje më të mira. Sarah Gilbert tha se bota duhet të mësojë nga pandemia e Covid-19. “Kjo nuk do të jetë hera e fundit që virusi do ta kërcënojë jetën tonë. E vërteta është që (pandemia) e ardhshme do të jetë më e keqe. Mund të jetë më ngjitëse ose më vdekjeprurëse, ose të dyja së

bashku. Përparimet që kemi bërë dhe njohuritë që kemi fituar, nuk duhet t'i humbasim”, ka thënë Gilbert.

Vaksina e prodhuar nga Universiteti i Oxfordit dhe kompania “AstraZeneca” ishte vaksina e parë kundër koronavirusit që fillimisht u miratua për përdorim në Mbretërinë e Bashkuar dhe aktualisht përdoret në mbi 170 shtete të botës.

Për shkak të rolit të saj në zbulimin e vaksinës, Gilbert është nderuar nga Mbretëresha Elizabeth II e cila ia ka dhënë titullin Damë. Ajo ka punuar në

prodhimin dhe testimin e vaksinave për më shumë se një dekadë, kryesisht duke përdorur antigjenët nga malaria dhe gripi dhe nisi projektin për prodhimin e vaksinës kundër koronavirusit në fillim të vitit 2020, pasi virusi u shfaq në Kinë në fund të vitit 2019.

Përderisa bota po përballet me variantin e ri të koronavirusit, “Omicron”, Gilbert bëri thirrje për kujdes të shtuar. “Derisa të dimë më shumë, ne duhet të jemi të kujdesshëm dhe të ndërmarrim hapa për ta frenuar përhapjen e këtij varianti të ri”, ka thënë ajo.



Escobar: Maqedonia e Veriut e ka vendin në BE



SHKUP, 6 DHJETOR - Zëvendësndihmëssekretari amerikan i Shtetit për Evropën dhe Euroazinë, Gabriel Escobar, ka thënë të hënën në Shkup se ShBA-ja e mbështet fuqishëm integrimin e Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Evropian. “Dua ta shpreh edhe një herë mbështetjen e fuqishme të administratës sonë për integrimin evropian të Maqedonisë së Veriut dhe ne po punojmë me partnerët tanë evropianë në mënyrë që kjo të ndodhë sa më shpejt. Mendoj se të gjithë jemi të mendimit se Maqedonia e Veriut është pjesë e Evropës si në aspektin

kulturor, historik, por edhe si ekonomi në rritje. Ju duhet ta keni vendin tuaj në tavolinë. Në këtë kuadër ne do të vazhdojmë t'i mbështetim përpjekjet tuaja në procesin integruar, në vazhdimin e reformave, që integrimi të bëhet realitet”, ka thënë Escobar, i cili është edhe i dërguar i ShBA-së për Ballkanin Perëndimor.

Diplomati amerikan ka theksuar edhe rëndësinë dhe ndihmën që mund të japë Maqedonia e Veriut në përballje me sfidat që mund të ketë jo vetëm Ballkani, por edhe Evropa në. “Ne folëm edhe për leadershipin e Maqedonisë së

Veriut në Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë dhe në NATO, që të na ndihmojë për zgjidhjen e çështjeve që e sfidojnë aleancën edhe në Ballkan, por edhe Evropën si tërësi, dhe po kërkojmë mënyra se si ta thellojmë këtë bashkëpunim, që tashmë është mbresëlënës”, ka deklaruar Escobar.

Ministri i Punëve të Jashtme i Maqedonisë së Veriut, Bujar Osmani, ka deklaruar se ShBA-ja është partnere strategjike e Shkupit, aleate e afërt në NATO dhe mbështetëse e fuqishme që prej se Maqedonia e Veriut ka shpallur pavarësinë.

Fauci: ‘Omicroni’ mund të shkaktojë simptoma më të lehta se ‘Delta’

NJU-JORK, 6 DHJETOR - Indikacionet e para sugjerojnë se varianti i ri i koronavirusit, “Omicron”, mund të shkaktojë simptoma më të lehta se varianti dominues “Delta”, thanë zyrtarët shëndetësorë në Shtetet e Bashkuara.

Shefi i këshilltarëve mjekësorë i Shtëpisë së Bardhë, Anthony Fauci, tha se shkencëtarëve u duhen më shumë informacione para se ta përcaktojnë ashpërsinë e variantit “Omicron”. “Deri tash nuk duket se ka një shikallë të lartë të ashpërsisë, por ne duhet të jemi të kujdesshëm para se të bëjmë përcaktime nëse është më pak i rëndë ose vërtet nuk shkakton ndonjë sëmundje të rëndë krahasuar me ‘Deltën’”, ka thënë Fauci.

Raportimet nga Afrika e Jugut, ku “Omicroni” u identifikua për herë të parë, dhe që atëherë po përhapet me shpejtësi edhe në

shtete të tjera, sugjerojnë se ky variant mund të shkaktojë simptoma më të lehta krahasuar me variantet paraprake.

“Omicroni” besohet se është më ngjitës sesa variantet e tjera, përfshirë variantin “Delta”, por shkencëtarët ende po punojnë për të kuptuar se sa efektiv është ky variant për ta shmangur mbrojtjen nga vaksinat.

Varianti i ri i koronavirusit është identifikuar në dhjetëra shtete, por “Delta” është varianti kryesor që ka shkakuar rritjen e rasteve në Evropë dhe në Amerikën e Veriut. Edhe nëse vërtetohet se “Omicroni” është më pak i rrezikshëm se “Delta”, ky variant do të vazhdojë të jetë problematik, tha për CBS, Maria Van Kerkhove, epidemiologe nga Organizata Botërore e Shëndetësisë.

“Edhe nëse kemi një numër të



madh rastesh që janë të lehta, disa nga të infektuarit do të kenë nevojë të shtrihen në spital. Ata do të duhet të

shtrihen në repartet e kujdesit intensiv dhe disa njerëz do të vdesin. Ne nuk duam që kjo të ndodhë, pasi veçse po

përballemi me një situatë të vështirë teksa ‘Delta’ është përhapur në mbarë botën”, ka shtuar Maria Van Kerkhove.

Liderët e institucioneve të Kosovës nderojnë ish-senatorin Dole

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 6 DHJETOR - Duke e çmuar lart kontributin e tij për pavarësinë e Kosovës, krerët e institucioneve më 6 dhjetor kanë vënë kurora me lule para bustit të ish-senatorit amerikan Bob Dole në Prishtinë.

Ish-senatori amerikan Bob Dole vdiq më 5 dhjetor në moshën 98-vjeçare. Dole një pjesë të karrierës ia kushtoi Kosovës dhe rrugës së saj drejt pavarësisë.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, tha se "gjatë viteve '90, kur askush nuk dinte për ekzistencën e shtetit të Kosovës, ishte senatori Dole i cili asnjëherë nuk i ndali përpjekjet e tij për pavarësinë e vendit".

Ndërkaq kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se senatori Dole ka bërë shumë për paqe në Evropë, madje jo vetëm si

politikan, por edhe si ish-veteran i luftës. Sipas kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, me vdekjen e senatorit Dole, Kosova humbi një mik të madh. "Ai e ka shtyrë përpara pavarësinë e Kosovës andaj populli i Kosovës do të jetë përjetësisht mirënjohës për punën e tij", tha Konjufca.

Bashkë me liderët e institucioneve të Kosovës ishte edhe i ngarkuari me punë në Ambasadën Amerikane në Prishtinë, Nicholas J. Giacobbe. "Dole ishte mik i madh i Kosovës. Ai punoi për pavarësinë e Kosovës dhe u përkujdes që edhe në Senatin Amerikan të kishte përkrahje për këtë", tha Giacobbe.

Në vitin 1990 Dole ka udhëhequr një delegacion të ShBA-së në Kosovë, vizitë e cila, siç ka deklaruar më vonë në një postim në "Twitter", "ishte fillimi i një



rrugëtimi drejt pavarësisë për popullin e Kosovës".

Për nder të angazhimit të tij për

Kosovën, busti i tij është vendosur në Prishtinë më 30 gusht 2020. Në atë kohë, përmes

një videomesazhi, Dole ka shprehur mirënjohjen për inaugurimin e bustit.

318 raste aktive me Covid në Kosovë

PRISHTINË, 6 DHJETOR (ER) - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se të hënën janë regjistruar edhe katër raste të reja me Covid-19. Rastet e reja dolën pas testimit të 1 817 mostrave. Sipas raportit, në 24 orët paraprake janë shëruar edhe tetë pacientë. Sipas Ministrisë së Shëndetësisë, aktualisht janë edhe 318 raste aktive me Covid-19. Sa i përket vaksinimit, brenda 24 orëve janë dhënë 372 vakcina kundër koronavirusit.

Që nga fillimi i fushatës së vaksinimit në Kosovë në mars, në gjithë vendin janë dhënë 1 626 061 doza të vaksinës. Deri më 6 dhjetor 766 206 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë.

Në Kosovë të drejtë vaksinimi kanë të gjithë personat mbi 12 vjeç. Ata mund të zgjedhin njërin prej vaksinave që janë në përdorim në Kosovë: vaksinën "Pfizer/BioNTech" ose atë "AstraZeneca".

Situata epidemiologjike në



Kosovë është vlerësuar se është e qetë, për dallim nga rajoni dhe Evropa që aktualisht po përballen me një valë të re të infeksioneve.

Në Kosovë më 6 dhjetor kanë hyrë në fuqi masat e reja kundër pandemisë, që kryesisht janë të fokusuar në paraqitjen e

dëshmimeve për vaksinim dhe testet negative për qytetarët që hyjnë në vend.

Duke folur për situatën me

pandeminë, kryeministri Albin Kurti ka bërë me dije një ditë më parë se fillimi i dhjetorit na gjen me situatën epidemiologjike më të qetë, jo vetëm në rajonin e Ballkanit Perëndimor, por edhe në të gjithë Evropën. "Këtë rezultat të shkëlqyer e kemi arritur bashkë - institucionet shtetërore në bashkëpunim me qytetarët e Republikës", ka thënë ai.

Kurti ka veçuar katër rreziqet me të cilat do të përballemi shumë shpejt, në një valë të re gjatë javëve dhe muajve në vijim, dhe ka ritheksuar domosdoshmërinë e rritjes së vigjilencës sonë. "Si kryeministër i Republikës së Kosovës nuk kam detyrë më të rëndësishme sesa të mbroj jetën dhe shëndetin e qytetarëve tanë, me të gjitha mjetet që qeveria i ka në dispozicion. Për këtë arsye, dhe vetëm për këtë arsye, kemi marrë masa kufizuese edhe brenda vendit, edhe në pikat kufitare", ka deklaruar Kurti.

Kurti vizitoi qytetarët afganë që po qëndrojnë në kampin Bondsteel

FERIZAJ, 6 DHJETOR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i shoqëruar nga i ngarkuari me punë në Ambasadën e Amerikës në Prishtinë, Nicholas J. Giacobbe, ka vizituar qytetarët afganë që po qëndrojnë në kampin Bondsteel.

Së bashku me zëvendëskryeministren për Çështje të Pakicave dhe të

Drejtat e Njeriut në Republikën e Kosovës, Emilija Rexhepi dhe ministrin e Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, kryeministri Kurti ka falënderuar zyrtarët amerikanë për komunikimin dhe bashkëpunimin e ngushtë "në këtë çështje humanitare për refugjatët të cilët kishin nevojë për mbështetjen tonë e që po i ndihmojmë së bashku".

Kryeministri Kurti ka thënë se është nder për ne që kishim mundësi t'i mirëpresim dhe t'u ndihmojmë qytetarëve afganë të cilët tani janë mysafirët tanë. Zyrtarët e kampit Bondsteel kanë shprehur mirënjohjen e tyre për angazhimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për strehimin e qytetarëve të shpërngulur nga konflikti në Afganistan.





VAZHDON PROCESI GJYQËSOR NË HAGË NDAJ HYSNI GUCATIT DHE NASIM HARADINAJT

Gucati: Do të jepja dorëheqje nëse do të rridhte ndonjë dokument nga zyra ime

Kryetari i Organizatës i Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK), Hysni Gucati, ka hedhur poshtë pretendimet e Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS) ndaj tij. Në dëshminë e tij para trupit gjykues të Dhomave të Specializuara në Hagë, ai ka fajësuar ZPS-në për nxjerrjen e dokumenteve në publik. Sipas tij, me këto veprime ata e kanë vënë në kurth atë dhe pjesëtarët e tjerë të UÇK-së. Në adresimin e tij, Gucati ka thënë do të jepte dorëheqje nëse do të rridhte ndonjë dokument nga zyra e tij në OVLUÇK

**EPOKA
ERE** **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 6 DHJETOR - Kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK), Hysni Gucati, ka paraqitur para Dhomave të Specializuara në Hagë dëshminë e tij. Para trupit gjykues ai ka hedhur poshtë pretendimet që Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) ka ngritur ndaj tij. Ai ka thënë se për rrjedhjen e dokumenteve është përgjegjëse vetë Gjykata Speciale.

Gucati ka bërë me dije se

dëshira e tij më e madhe është që të zbulohet se si kanë rrjedhur ato dokumente nga Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS). “Dëshira ime më e madhe dhe e shokëve të mi është që të zbulohet ky rast, pikërisht nga prokurorët e nderuar, që kush i publikoi këto dokumente nga zyrat e tyre. Mund të jetë një njëri i tyre që këta nuk duan ta bëjnë zbulimin. Kështu që unë kam dëshirën më të madhe dhe u kam bërë ftesë publike në atë kohë hetuesve të Gjykatës Speciale, që ta zbulojnë njeriun i cili më qiti në kurth mua dhe

organizatën e veteranëve me ato dokumentacione. Unë këtë e llogaris një kurth ndaj pjesëtarëve të UÇK-së dhe ndaj meje e Nasim Haradinajt dhe të gjithë shokëve tanë”, ka thënë Gucati. Ai ka vlerësuar se do të jepte dorëheqje nga udhëheqja e OVLUÇK-së nëse do të rridhte ndonjë dokument nga zyra e tij. “Vetëm një letër po të dilte nga OVLUÇK-ja brenda 24 sekondave do të thërrisja mediat dhe do të jepja dorëheqje nëse dokumenti do të dilte nga zyra ime. Kjo do të jetë në ndërgjegjen e tyre, por këtë do ta bëja për hir të moralit dhe etikës së punës. Kjo gjykatë është e ndjeshme. Ka ardhur këtu në Holandë për shkak të sigurisë dhe del se nuk ka fare siguri”, ka thënë ai.

Në dëshminë e tij, Gucati ka folur për fshatin e tij dhe krimet që janë kryer aty nga forcat serbe. “Kam marrë pjesë personalisht në ofensivën e 3 gushtit të vitit 1998. Kemi pasur humbje. Është vrarë dëshmori i kombit Zenel Mziu, i cili ka

qenë student i vitit të fundit në fakultet. Po ashtu, një qytetares së moshuar nga Morina, Hajrije Mziu, i është prerë koka me sëpatë. Këtë e kam parë me sytë e mi. Në fshatin Morinë janë 39 të vrarë dhe 13 të zhdukur”, ka thënë ai.

Gucati ka treguar se është plagosur më 2 qershor në ofensivën e fundit në vitin 1999 në malet e Berishës. “Unë jam i plagosur në këmbën e djathtë dhe jam i operuar 27 herë. Ditën e parë kam marrë trajtim në spitalin tonë të improvizuar në bjeshkë dhe të dytin në Spitalin Ushtarak në Tiranë, ku më kanë dërguar forcat angleze, të cilat kanë sjellë ndihmë në malet e Berishës”, ka deklaruar ai. Ai ka thënë se aktualisht bën kontrolle mjekësore në Spitalin e Holandës dhe ka nevojë edhe për një operacion.

Më pas, Gucati ka treguar për sjelljen e dokumenteve në zyrat e OVLUÇK-së, duke thënë se për ta ka qenë diçka e habitshme. “Ka ndodhur për herë të parë. Kjo na ka befasuar

të gjithëve që nuk ka ndodhur kurrë për 20 vjet. Ka ardhur një paketë e dyshimtë, e cila është lënë në zyrën e sekretares te recepsioni mbi tavolinë”, ka thënë ai, duke treguar se çfarë ka ndodhur atë ditë. Sipas tij, sekretarja e kësaj organizate e kishte parë e para pakon e dyshimtë. “Me një bërtitim që ende e kam në veshin tim, ka menduar që ka bombë në paketë. Ka treguar se ka ardhur një person i maskuar dhe ka lënë një paketë në tavolinë dhe ka ikur. Pas një kohe kemi mësuar se ka thënë se do të sjellë prapë paketa. ‘Kjo paketë është për ata që flasin në televizion’. Kështu ka thënë”, ka treguar Gucati.

Ai ka bërë me dije se personin që e ka sjellë këtë paketë e ka parë vetëm në kamera. “Të jem i sinqertë, ishte rasti i parë që ka ndodhur. Ishte befasi. Ndoshta për ju është humor, por po ju them se është e vërtetë. Me një shtagë e kemi shpaluar paketën dhe e kemi parë se ka dokumentacione dhe nuk kemi

Stano: Prishtina dhe Beogradi nuk kanë gatishmëri për dialog

PRISHTINË, 6 DHJETOR - Pak ka gjasa që së shpejti të ketë takim të ri në kuadër të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë në nivelin më të lartë politik. Zyrarët e Bashkimit Evropian (BE), të informuar me procesin, thanë të hënën (6 dhjetor) se në këtë moment nuk ka gatishmëri as të Prishtinës e as Beogradit që të angazhohen në mënyrë konstruktive në dialog. Zëdhënësi i Bashkimit Evropian, Peter Stano, paralajmëroi që parakusht për aranzhimin e takimit të radhës duhet të jetë gatishmëria e palëve që të merren vesh rreth rezultateve konkrete, në të mirë të qytetarëve të tyre. “E kemi bërë shumë të qartë, pas dy takimeve këtë vit, që parakusht për takimin e radhës duhet të jetë gatishmëria e të dyja palëve që të

pajtohen rreth rezultateve konkrete për të mirën e qytetarëve të tyre. Kontaktet e fundit të përfaqësuesit të lartë të BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri (Josep Borrell) dhe diplomacia e përfaqësuesit të BE-së për dialog, Miroslav Lajçak, treguan që aktualisht nuk ka gatishmëri”, tha Stano.

Sidoqoftë, më 1 dhjetor, derisa fliste nga Riga në takimin e ministrave të jashtëm evropianë me NATO-n, Borrell theksoi se Kosova dhe Serbia duhet të kthehen sa më parë në tavolinën e negociatave.

Në fund të nëntorit i dërguari i posaçëm i BE-së për dialog, Lajçak, vizitoi Prishtinën e Beogradin në tentimin që ta organizojë raundin e ri të takimit

në nivelin më të lartë.

Gjatë vizitës në Prishtinë më 25 nëntor, Lajçak tha se ka hapësirë për përparim në kuadër të dialogut derisa theksoi rëndësinë strategjike të këtij procesi për të gjithë Bashkimin Evropian.

Pas takimit me kryeministrin Kurti, Lajçak tha se nuk është i rëndësishëm vetëm caktimi i takimit, por edhe rezultati që mund të ketë ai.

Nga vizitat në Prishtinë e Beograd, burimet e “Radios Evropa e Lirë” kanë thënë se Lajçak është kthyer krejtësisht i dekurajuar.

Që nga koha kur Albin Kurti u bë kryeministër i Kosovës, në kuadër të dialogut ai është takuar vetëm dy herë me presidentin serb Aleksandër Vuçiq. Që të dyja takimet ishin të pasuksesshme

dhe dëshmuar se sa larg qëndrojnë palët në qasjen e tyre ndaj dialogut.

Pikërisht kjo i detyroi zyrarët evropianë që të deklarojnë se takimi i tretë do të ndodhë vetëm nëse do të ketë gatishmëri për përparim në dialog.

Më 5 dhjetor, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se është diskutuar mundësia që në javën e dytë të dhjetorit të ketë një takim në Bruksel me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq.

Të martën kryeministri Kurti do të qëndrojë në Bruksel, por gjatë kësaj vizite do t'i takojë zyrarët e lartë evropianë përfshirë edhe shefin e diplomacisë, Borrell, por takim me presidentin serb, Vuçiq, nuk do të ketë.

Sipas burimeve në Bruksel, takimi

me Borrellin do të jetë mundësia e fundit për këtë vit që të tentohet të organizohet takimi i tretë në mes të Kurtit dhe Vuçiqit.

Bisedimet për normalizim të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë kanë filluar qysh në vitin 2011. Që nga ajo kohë janë arritur një sërë marrëveshjesh, porse shumica prej tyre nuk janë zbatuar në praktikë.

Dialogu u ndërpre disa herë për arsye të ndryshme por, së fundmi, pengesë në dialog u bë marrëveshja për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë.

Qëllim i dialogut thuhet të jetë arritja e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse dhe ligjërisht e obligueshme për të dyja palët. (Rel)



guxuar t'i afrohem paketës, duke u frikësuar se mos ka ndonjë bombë”, ka thënë ai. Sipas tij, brenda pakos ka pasur materiale dhe një fletë në të cilën ka shkruar se do t'i sjellin edhe 7 000 dosje.

Avokati i tij, Jonathan Elystan Reese, e ka pyetur Gucatin nëse i ka parë dokumentet. “Shumë pak. Nuk kishim kohë”, është përgjigjur Gucati. Ai ka deklaruar se pastaj me kryesinë e ngushtë të OVLUÇK-së kanë diskutuar se çfarë do të bëjnë me këto dokumentacione. Gucati ka treguar pse kanë vendosur që t'i ftojnë mediat e

Kosovës. “Arsyeja ishte shumë e thjeshtë. Nuk kemi dashur që ta mbajmë këtë barrë, që të thonë se OVL i ka pasur në zyrë”, ka thënë ai.

Trupi gjyqes nuk miraton kërkesën e mbrojtjes së Haradinajt

Trupi gjyqes nuk ka pranuar kërkesën e avokatit të Nasim Haradinajt, Toby Cadman, që të shtyhen seancat gjyqësore. Avokati Cadman ka kërkuar shtyrjen e gjykimit për shkak të infektimit me Covid. “Në këtë

fazë unë po kërkoj thjesht një shtyrje të përkohshme në mënyrë që të mund të kontaktoj me z. Haradinajt dhe në mënyrë që t'i marr udhëzimet e plota nga ai. Pra, nëse dëshiron që ne të vijojmë ose nëse është për shtyrje”, ka thënë Cadman.

Ndërsa prokurorja Valeria Bolicci ka deklaruar se në çështjen Haradinajt ka dy bashkëmbrojtës që janë të disponueshëm. Sipas saj, njëri mund ta ndjekë seancën online, tjetri mund të jetë i pranishëm. “Bashkëmbrojtësi në gjykatë mund t'i ndjekë seancat private,

andaj nuk ka justifikim për shtyrjen e seancave të planifikuara”, ka thënë ajo.

Gjykimi ndaj Gucatit dhe Haradinajt ka filluar në muajin tetor të këtij viti, ndërsa Zyra e Prokurorit të Specializuar e ka mbyllur çështjen e saj në nëntor. Hysni Gucati së bashku me Nasim Haradinajn po akuzohen për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë, konkretisht për pengim të personave zyrtarë gjatë kryerjes së detyrave zyrtare, për frikësim të dëshmitarëve, për hakmarrje dhe për shkelje të fshehtësisë së procedurës. “Akuzat e

paraqitura në aktakuzën e konfirmuar mbështeten në dyshimin e bazuar mirë se së paku midis 7 dhe 25 shtatorit 2020, z. Gucati dhe z. Haradinajt zbuluan pa autorizim informacion të mbrojtur prej Ligjit të Dhomave të Specializuara, ndër të cilat të dhëna identifikuese të disa dëshmitarëve (të mundshëm), në tri konferenca shtypi dhe aktivitete të tjera të transmetuara, si edhe përmes shpërndarjes së mëtejshme ku përfshihen deklaratat në rrjetet sociale”, thuhej në njoftimin e Dhomave të Specializuara.

Shaqir Totaj pranon zyrtarisht detyrën e kryetarit të Prizrenit

PRIZREN, 6 DHJETOR (ER) - Të premten zyrtarisht Shaqir Totaj ka pranuar detyrën e kryetarit të Prizrenit nga ish-kryetari i deritanishëm, Mytaher Haskuka. Totaj ka falënderuar Haskukën për angazhimin e tij në këto katër vjet për Prizrenin dhe qytetarinë e treguar me rastin

e pranim-dorëzimit të detyrës. “Tani është koha për atë që kemi thënë, premtuar dhe për çka kemi kërkuar besimin tuaj: Punën për Prizrenin. Në këtë mision ne do të jemi bashkë me të gjitha ata të cilët sikur ne kërkojnë një qytet më të zhvilluar, më të pastër, më funksional, me

mundësi më të mëdha e të barabarta për të gjithë në edukim e punësim. Për qytetarët e Prizrenit premtoj vetëm atë që ata e meritojnë: Një qeverisje jodiskriminuese, transparente, me qendër qytetarin dhe të afërt me të. Puna për Prizrenin nis sot”, ka thënë Totaj.



Vrasja në Glllogjan të Deçanit, Kurti: Hetuesit më të mirë të vendit po merren me këtë rast

PRISHTINË, 6 DHJETOR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka deklaruar se sasia e informacioneve për vrasjen e trefishtë në Glllogjan të Deçanit është duke u shtuar. Ai pasi ka bërë homazhe te busti i senatorit Bob Dole, ka thënë se hetuesit më të mirë janë të përfshirë në këtë rast. “Sasia e informacionit për vrasjen e trefishtë në Glllogjan të Deçanit është duke u shtuar, meqenëse hetuesit më të mirë tanë janë të përfshirë atje. Mirëpo kur të kenë diçka konkrete sa i përket të pandehurit ose të pandehurve që e kryen këtë vrasje të trefishtë mizore, ne natyrisht që do t’ju njoftojmë me kohë”, ka thënë ai.

Autobusi ka qenë duke qarkulluar në relacionin Gjakovë - Deçan në kohën kur kanë ndodhur të shtënat.

Nuk është ende e qartë nëse autobusi ka qenë cak i të shtënave.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, dhe kryeministri Albin



Kurti e patën cilësuar ngjarjen “tronditëse” dhe i kanë ftuar organet e rendit që t’i zbulojnë autorët e krimit dhe t’i sjellin para

drejtësisë. Ende nuk dihet autori e as motivet e sulmit që tronditi Deçanin mbrëmjen e së premtes të 26 nëntorit.

Ngjarjen e kanë dënuar edhe përfaqësues të tjerë të institucioneve dhe partive politike në Kosovë. Ndërkohë, Qeveria e

Kosovës ka premtuar 20 mijë euro për çdo qytetar që jep informacione për të dyshuarit që janë të përfshirë në këtë vrasje.

Kryetari i Skenderajt: Shëndetësia, prioritet i qeverisjes sonë lokale



SKENDERAJ, 6 DHJETOR (ER) - Kryetari i Skenderajt, Fadil Nura, së bashku me nënkryetarin e komunës, Sami Lushtaku dhe me drejtoreshën e Shëndetësisë, Rrezarta Hasani, kanë vizituar Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Skenderaj. “Nga drejtori si dhe nga stafi shëndetësor u njoftuam rreth kushteve e shërbimeve që ofrohen në QKMF dhe në ambulancat e mjekësisë familjare në bashkësi

lokale”, ka thënë Nura. Ai ka theksuar se shëndetësia është prioritet i qeverisjes sonë lokale. “Shpejt do ta funksionalizojmë Shtabin Emergjent për Covid-19, do ta rregullojmë çështjen e autoparkut në oborrin e QKMF-së si dhe do të shikojmë rreth mundësisë për stimulimin e mjekëve që të qëndrojnë në vend. Do të jemi afër qytetarëve për të ofruar shërbime të shpejta e cilësore”, ka deklaruar Nura.

Xhafer Tahiri ia dorëzon detyrën e kryetarit të Vushtrrisë, Ferit Idrizit

VUSHTRRI, 6 DHJETOR (ER) - Xhafer Tahiri të premten ia ka dorëzuar mandatin e kryetarit të komunës së Vushtrrisë, Ferit Idrizit. Tahiri përmes një postimi në llogarinë e vet në “Facebook” ka shkruar se është krenar që i ka shërbyer me nder qytetit të

Vushtrrisë. “Bashkë me bashkëpunëtorë e kam pritur në zyrë kryetarin e ri të Vushtrrisë, z. Ferit Idrizi, ku me procesverbal i kam dorëzuar detyrën, bashkë me projektet në realizim e sipër. Z. Idrizit i uroj shëndet e suksese në punë. Jam krenar që i kam

shërbyer me nder qytetit që e duam, për ndryshimin që e kemi sjell në Vushtri e kulturën demokratike të qeverisjes. Do të jem përherë në shërbim të mirëqenies së qytetarëve të Vushtrrisë dhe zhvillimit e prosperimit të qytetit”, ka shkruar Tahiri.



Vlerësohet puna e strehimoreve për luftimin e dhunës në familje

PRISHTINË, 6 DHJETOR (ER) - Ofrimi i shërbimeve të specializuara mbështetëse për viktimat e dhunës në familje dhe roli i strehimoreve në mbrojtjen dhe rehabilitimin e tyre ishin temat e takimit të sotëm të kryeministrit Albin Kurti me udhëheqëset e strehimoreve. Kurti ka vlerësuar punën e strehimoreve si partnere në luftimin e dhunës në familje, të përfshira drejtpërdrejt në mbrojtjen e grave viktimat të dhunës dhe fëmijëve të tyre.

Në këtë takim u bisedua për nismat e ndërmarra nga qeveria për infrastrukturë të re ligjore, për hartimin e ligjit të ri për mbrojtje nga dhuna në familje si dhe Strategjinë për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026.

Në takimin e përbashkët me zëvendësministren e Drejtësisë, Nita Shala, njëherësh koordinatore nacionale kundër dhunës në familje, dhe me udhëheqësen e Agjencisë për Barazi Gjinore

në Zyrën e Kryeministrit, Edi Gusia, kryeministri u njoftua nga udhëheqëset e strehimoreve për angazhimin dhe sfidat në fushën e përgjegjësisë së tyre, në fazat e reagimit ndaj rasteve të dhunës në familje, për mbrojtjen, rehabilitimin dhe riintegrimin në shoqëri të viktimave të dhunës në familje.

Po ashtu u diskutua për hapat e mëtejshme që do ta forcojnë edhe më tej zbatueshmërinë e drejtpërdrejt të Konventës së



Stambollit në kornizën tonë ligjore dhe zbatimin e kërkesave që burojnë nga kjo

konventë, e që do ta udhëzojnë më tej punën e institucioneve përgjegjëse.

Mjekët paralajmërojnë grevë, i japin ultimatum Kurtit deri më 15 dhjetor

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 6 DHJETOR - Federata e Sindikatave e Shëndetësisë së Kosovës (FSSHK) ka paralajmëruar se deri më 15 dhjetor do të presin lidhur me kërkesat e tyre për Ligjin e Pagave, më pas do të ndërmarrin veprime të organizuara sindikale. "Sot në mbledhjen e Këshillit Drejtues të Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës është diskutuar në lidhje

me ecurinë e grevave të organizuara ditë më parë si dhe për çështjet e ngritura para qeverisë nga kjo federatë. FSSHK-ja deri më 15 dhjetor do të bisedojë me secilin anëtar të vet dhe njëkohësisht pret reflektim nga qeveria për të cilën ka formuar një grup negociues. Nëse edhe kjo nuk ndodh, FSSHK-ja paralajmëron masa radikale sindikale, siç është ndërprerja e punës në të gjitha institucionet publike shëndetësore", është bërë me dije

në komunikatën e FSSHK-së. Këshilli Drejtues i FSSHK-së ka bërë thirrje edhe një herë që Ligji mbi Pagat të procedohet, miratohet dhe implementohet me buxhetin e vitit 2022. "Këshilli Drejtues i FSSHK-së unanimisht kërkon nga Qeveria e Republikës së Kosovës që nëse Ligji i Pagave nuk kalon të ketë rritje të pagave për të gjithë të punësuarit në sistemin shëndetësor në lartësi prej 50-përqindësh, kjo bazuar në faktin se nuk ka pasur rritje pagash që nga viti 2014. Këshilli

Drejtes i FSSHK-së ia kujton gjendjen e rëndë të punëtorëve shëndetësorë si pasojë e inflacionit dhe shtrenjtimit të jetës, rritje kjo e cila do të ndikonte në zbutjen e kësaj gjendjeje. Kjo rritje do të vlente deri në fillimin e implementimit të Ligjit të Pagave. Mbesim me shpresë se qeveria do të reflektojë, në të kundërtën për të gjitha pasojat e mundshme përgjegjësinë e bartë Qeveria e Republikës së Kosovës", është theksuar në komunikatën e

FSSHK-së. Para disa ditësh edhe Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK) ka mbajtur takim të jashtëzakonshëm me përfaqësues të të gjitha federatave anëtare. Të gjitha sindikatat kanë shprehur pakënaqësitë e tyre dhe kanë kërkuar që Ligji i Pagave të zbatohet sa më shpejt. Me këtë rast ato kanë bërë me dije se kanë anuluar grevën dhe protestat dhe i kanë dhënë afat qeverisë që deri në fund të muajit mars ky ligj të shkojë për miratim në Kuvend.

ShSKUK-ja fillon bashkëpunimin me Universitetin "Johns Hopkins" të ShBA-së

PRISHTINË, 6 DHJETOR (ER) - Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) ka filluar bashkëpunimin me Universitetin "Johns Hopkins" të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Kontaktet e para zyrtare janë vënë të premtën përmes një telekonference ku është diskutuar në lidhje me trajtimin e pacientëve të prekur me Covid-19 dedikuar anesteziologëve-

intensivistëve të ShSKUK-së, në të cilën mori pjesë dr. Arbër Shehu, mjek i diplomuar në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë, që tash punon në Universitetin "Johns Hopkins", përmes të cilit është bërë i mundur kontakti edhe me profesorët më eminentë të këtij universiteti, dr. David Hager dhe dr. William Garneau. Kryesuesja e Bordit të Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, dr.

Agreta Gecaj-Gashi dhe drejtori i ShSKUK-së, dr. Valbon Krasniqi, kanë shprehur mirënjohje dhe kanë vlerësuar lart kontributin e profesorëve nga Universiteti "Johns Hopkins" në këtë konferencë, e cila është e domosdoshme dhe e mirëseardhur për Shërbimin Spitalor Klinik Universitar. Përveç QKUK-së, konferenca është transmetuar edhe në spitalet e përgjithshme.



Kosova merr pjesë në Panairin Ndërkombëtar të Turizmit në Izmir, paraqiten potencialet dhe ofertat turistike

PRISHTINË, 6 DHJETOR - Unioni i Turizmit i Kosovës (UTK) ka njoftuar se ka marrë pjesë në Panairin Ndërkombëtar të Turizmit në Izmir, ku ka paraqitur potencialet dhe ofertat turistike të vendit. Sipas UTK-së, janë zhvilluar shumë takime ndërmjet operatorëve ekonomikë për të sjellë grupe

turistësh në Kosovë. UTK-ja thotë se ka pasur takim me presidentin e Shoqatës së Bizneseve "Batuder", Akin Kazançoğlu, me të cilin kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me qëllim të thellimit të bashkëpunimit në sektorin e turizmit dhe investimeve në Kosovë. Po ashtu,

Unioni i Turizmit i Kosovës thotë se është prituri nga Oda Ekonomike dhe Tregtare e Izmirit, përkatësisht kryetari Mahmut Ozgener, drejtori për investime dhe drejtori për turizëm, me të cilët përfaqësuesit e UTK-së kanë diskutuar për thellimin e bashkëpunimit dhe harmonizimin e aktiviteteve të



përbashkëta.

Delegacioni thotë se është takuar edhe me kryesinë e Shoqatës Shqiptare në Izmir dhe me

shumë përfaqësues të bizneseve atje, me qëllim të vendosjes së urave të komunikimit dhe të bashkëpunimit.

Paraqitet Strategjia për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2021-2027

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 6 DHJETOR - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci, ka marrë pjesë në takimin e grupit drejtues për hartimin e Strategjisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2021-2027 në të cilin është diskutuar lidhur me Strategjinë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, politikë kjo e cila ka për qëllim krijimin e një baze të qartë për zhvillimin e sektorit

të bujqësisë në vend.

Strategjia për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2021-2027 gjithashtu lidhet ngushtë me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm, asaj të agjendës së gjelbër të Bashkimit Evropian, si dhe përafrimin me politikat e përbashkëta bujqësore dhe ka për qëllim të adresojë një sërë objektivash që ndërlihdin institucionet relevante të Republikës së Kosovës.

Ministri Peci ka theksuar se

misioni i Strategjisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2021-2027 është që ta transformojë sektorin e ekonomisë agrorurale duke e bërë atë gjithëpërfshirë, produktive, të qëndrueshme dhe konkurruese si brenda tregut vendor, po ashtu edhe jashtë saj. "Ky dokument trajton rritjen e konkurrencës në sektorin agroshqimor, menaxhimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore, mbështetjen e bizneseve në zhvillimin e

zonave rurale, sigurinë ushqimore dhe reformat e nevojshme në administratë siç edhe jemi zotuar në takimet e shumta ndërministrorë, duke rikonfirmuar partneritetet e vendeve tona me organizata mike që i kontribuojnë zhvillimit të sektorit dhe t'i shkëmbejmë përvojat për implementimin e standardeve të IPARD", është shprehur ministri Peci.

Vlen të theksohet se për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë

dhe Zhvillimit Rural Strategjia për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2021-2027 është e para dhe se kësaj strategjie i ka paraprirë edhe një analizë sektoriale për disa nga sektorët kryesorë të bujqësisë dhe zhvillimit rural, si sektori i bimëve, blegtoria dhe diversifikimi rural dhe zhvillimi i ekonomisë rurale, andaj MBPZHR-ja përmes kësaj strategjie tanimë i ka të qarta objektivat e saj që i kontribuojnë zhvillimit të sektorit të bujqësisë.



Dështon emërimi i bordit të ri të OShP-së

PRISHTINË, 6 DHJETOR - Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) do të vazhdojë të mbesë ende pa bord. Ky organ nuk do të mund t'i trajtojë ankesat rreth tenderëve të ndryshëm. Nga prilli i këtij viti e deri në

dhjetor janë mbi 500 tenderë në vlerë gati rreth 200 milionë euro të cilët janë bllokuar. Kuvendi sot me 2 vota për, 64 vota kundër dhe asnjë abstenim nuk i emëroi prapë anëtarët e tij. Emrat e

personave për bord të OShP-së që nuk votuan: Ardian Behra - kryetar, Hasim Krasniqi - anëtar, Faruk Rexha - anëtar, Adem Spahiu - anëtar dhe Ruzhdi Morina - anëtar.



Përtej migrimit: Si po përballen vendet me popullsinë në plakje



Nga Jennifer SCIUBBA

Në vitin 1950, mosha mesatare e atyre e banorëve në rajonet sot më të zhvilluara të botës ishte 29 vjeç. Shumica e tyre po përjetonin bumin e lindshmërisë së madhe të pasluftës, përfshirë Japoninë, e cila pushtoi kopertinën e revistës "Newsweek" për shkak të shqetësimeve mbi urinë masive përballë rritjes shumë të madhe të popullsisë.

Por një rritje e tillë demografike ishte jetëshkurtër. Vitin e kaluar, mosha mesatare e popullsisë në këto rajone ishte 42 vjeç, dhe nga mesi i dekadës së ardhshme, do të jetë 45-vjeç.

Dhe kjo trajektore e qëndrueshme në rritje do të thotë se pas çdo viti që kalon, shtetet e zhvilluara e gjejnë veten në një territor të pa eksploruar, duke u përpjekur që të krijojnë një "menu" me opsione të qëndrueshme politikash për të parandaluar si plakjen e popullsisë po ashtu edhe efektet që ajo ka në

ekonomi.

Një nga zgjidhjet e propozuara janë kufijtë dukshëm më të hapur. Shumë

ekspertëargumentojnë se shtetet në plakje, duhet të pranojnë më shumë emigrantë sesa aktualisht, në të kundërt do të përballen me pasoja të tmerrshme. Megjithatë, ajo që prirjen të shpërfillin diskutime të tilla është se ndonjëherë shtetet do të zgjedhin edhe pasojat.

Një arsye pse shtetet dhe shoqëritë mund të hezitojnë të shtojnë emigracionin – apo ta kundërshtojnë atë në mënyrë aktive- është se shpesh migrimi përshpejton ndryshimet në përbërjen etnike të popullatës. Ndërsa 76 për qind e të lindurve në SHBA, identifikohen si të bardhë të një race të vetme, vetëm 45 për qind e emigrantëve në vitin 2019 e kanë bërë këtë. Dhe siç e pamë me votuesit kundër emigrantëve që votuan pro Brexit në Britani, ndryshimet e perceptuara në përbërjen etnike ndikojnë në sjelljen politike.

Me një popullsi totale në tkurrje,

dhe me moshën mesatare më të vjetër në botë -48 vjeç – japonezët janë të bindur deri më sot se pasojat sociale të imigrimit janë më të mëdha se pasojat ekonomike të plakjes së popullsisë.

Përfundimisht bën migrimi i punonjësve të kujdesit, pasi llojet e kujdesit për të moshuarit janë të dukshme për familjet japoneze. Emigrantët përbëjnë rreth 2 për qind të popullsisë së Japonisë, ndërsa ka pengesa të rëndësishme institucionale që emigrantët të vendosen përgjithmonë me banim atje. Disa shtete janë shumë të rezervuara në lidhje me pasojat etnike të emigrimit, por shohin se përfitimet ekonomike janë më të mëdha se sa pasojat sociale. Koreja e Jugut, që vitet e fundit ka mbajtur rekordin botëror për shkallën më të ulët të lindshmërisë, është përpjekur të joshë rikthimin e koreanëve etnikë që jetojnë jashtë vendit, ashtu siç po bën edhe Rusia.

Por politikë-bërësit koreano-jugorë janë bërë më të hapur përtej emigrantëve

koreanë, si një nga disa politikat që synojnë t'i kundërvihen plakjes së popullsisë. Shembuj të tillë si migrimi i punonjësve të kujdesit për të moshuarit, forcojnë nevojën për të analizuar ndikimin e plakjes në sektorë të veçantë.

Në Shtetet e Bashkuara, punëtorët e ndërtimit po plaken; 40 për qind e këtyre punëtorëve janë nga mosha 45-64 vjeç, dhe 65 për qind e operatorëve të pajisjeve të rënda janë mbi 40 vjeç. Dhe me përfitimet e produktivitetit nga procesi i automatizimit, do të vijë shumë shpejt një ditë kur punëtorët e moshuar në sektorin e ndërtimit, do të duhet të dalin në pension.

Atëherë, kush do të përdorë mjetet për planet ambicioze në infrastrukturë të administratës Bajden? Ne kemi nevojë për një panoramë të gjerë të asaj se si mund të duket "migrimi" në tëardhmen, një tablo që përfshin rregullimet ligjore të përkohshme.

Por mosmarrëveshjet e forta ndërpartiake e kanë ngrirë prej

dekadash reformën e migracionit në SHBA.

Një çështje tjetër që lidhet me emigracionin është mosha dhe plakja e vetë emigrantëve.

Pak fëmijë migrojnë, dhe normat e lindshmërisë për emigrantët përputhen shpejt me atë të popullsisë vendase. Emigrantët që qëndrojnë atje plaken me kalimin e kohës.

Në vitin 2019, viti ynë i fundit mbi të dhënat para Covid-19, mbi 3/4 e emigrantëve në Shtetet e Bashkuara ishin në moshën kryesore të punës, 18 deri në 64 vjeç. Ky është një element pozitiv, por nga ana tjetër do të thotë se emigracioni nuk do t'i kundërvihet direkt plakjes së popullsisë në Amerikë.

Me më pak punëtorë në dispozicion nga viti në vit, migrimi duket si një zgjidhje e natyrshme për një fuqi punëtore në tkurrje, por nuk është ilaçi çudibërës. Në fakt, nuk ka një të tillë, dhe vetëm për shkak se një vend po plaket, nuk do të thotë se rritja e emigracionit është një zgjidhje. / "National Interest" – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE 'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Në grupin B, tri klube kërkojnë kualifikimin

Sonte zhvillohen tetë ndeshjet e fundit në katër grupe të Ligës së Kampionëve, kurse vëmendja kryesore do të jetë në grupin B. Kualifikimin e kërkojnë tri klube, Milani, Porto dhe Atletico Madridi, ndërsa më herët kualifikimin e ka siguruar i pari në grup Liverpooli

kualifikim. Në ndeshjet e tjera Milani i ka humbur tri dhe ka barazuar në një ndeshje. Kuqezinjtë, nëse e mposhtin Liverpoolin dhe ndeshja Porto - Atletico kryhet baras ose fiton skuadra spanjolle, do ta sigurojë kualifikimin. Porto është e dyta në



grup me 5 pikë dhe me fitore do ta siguronte kualifikimin, por edhe me barazim, por nëse Milani nuk fiton kundër Liverpoolit. Olivier Giroud, Samu Castillejo, Ante Rebiq, Davide Calabria dhe Simon Kjaer i mungojnë Milanit në këtë ndeshje, ndërsa Liverpooli do të jetë pa Roberto Firminon, Curtis Jones, Harvey Elliott dhe James Milner. Ndeshje interesante do të

zhvillohet edhe në Grupin D në mes të Real Madridit dhe Interit. Reali është në vendin e parë me 12 pikë dhe i mjafton një barazim për të kaluar më tutje si i pari i grupit, kurse kampioni në fuqi i Italisë, Interi, do të përpiqet t'i marrë pikët e plota dhe të kalojë në vendin e parë. Sheriffi e ka të siguruar vendin e tretë dhe merr pjesë në Ligën e Evropës.

"Epoka e re"

MILANO, 6 DHJETOR - Skuadra e Liverpoolit ka treguar formë të lartë në këtë edicion të Ligës së Kampionëve. Pesë ndeshjet e zhvilluara në fazën e grupeve i ka fituar dhe synon ta sigurojë edhe fitoren e gjashtë sonte (e martë) në përballje me Milanin në "San Siro". Për dallim nga skuadra e Jurgen Kloppit që e ka siguruar kualifikimin, Milani është i përfshirë me dy skuadrat e tjera në garë për vendin e dytë në grup. Në ndeshjen e parafundit Milani ka shënuar fitore ndaj Atletico Madridit (0-1) dhe falë këtyre tri pikëve ende është në garë për

GRUPI A				GRUPI C			
18:45 Paris Saint-Germain - Club Brugge				21:00 Ajax - Sporting			
18:45 Leipzig - Manchester City				21:00 Borussia Dortmund - Besiktas			
Tabela				Tabela			
1. Manchester City	5	12 pikë	1. Ajax	5	15 pikë		
2. PSG	5	8	2. Sporting	5	9		
3. Leipzig	5	4	3. Borussia Dortmund	5	6		
4. Club Brugge	5	4	4. Besiktas	5	0		
GRUPI B				GRUPI D			
21:00 Milan - Liverpool				21:00 Real Madrid - Inter			
21:00 Porto - Atletico Madrid				21:00 Shakhtar Donetsk - Sheriff			
Tabela				Tabela			
1. Liverpool	5	15 pikë	1. Real Madrid	5	12 pikë		
2. Porto	5	5	2. Inter	5	10		
3. Milan	5	4	3. Sheriffi	5	6		
4. Atletico Madrid	5	4	4. Shakhtar	5	1		

Morina, MVP në xhiron e pestë të Ligës Unike



PRISHTINË, 6 DHJETOR - Java e pestë në Ligën Unike ka dhuruar ndeshje mjaft interesante. Basketbollisti me indeksin më të lartë të xhiros së pestë ishte qendra e Golden Eagle Yllit, Gëzim Morina. Ai ndaj Kamza Basket kishte 13 pikë, pesë kërcime dhe shtatë asistime, duke e pasur indeksin e lojës 27, apo më të lartin e xhiros. Morina ndihmoi Yllin të fitojë ndaj Kamza Basket 89:75. Peja shënoi fitore bindëse ndaj Prizrenit 16 me rezultat 97:60. Te verdhezinjtë nga 10 asistime kishin Dardan

Berisha dhe Ilter Erdem. Berisha kishte edhe 18 pikë e katër kërcime, kurse Erdem 14 pikë e pesë kërcime. Tirana, pas vazhdimëve, ka mundur Teutën, ku u dallua qendra e kombëtares shqiptare, Endrit Hysenagolli, me

15 pikë e 13 kërcime. Rahoveci bëri përmbysje të madhe ndaj Vllazisë, ndërsa lojtari me efikasitetin më të lartë te Vreshtarët ishte Milik Yarbrough, i cili kontribuoi me 20 pikë, 12 kërcime dhe dy asistime.

TOP PESËSHJA

Gëzim Morina	(Golden Eagle Ylli) 13 pikë, 5 kërcime, 7 asistime
Dardan Berisha	(Peja) 18 pikë, 4 kërcime, 10 asistime, 24
Ilter Erdem	(Peja) 14 pikë, 5 kërcime, 10 asistime
Endrit Hysenagolli	(Tirana) 15 pikë, 13 kërcime
Milik Yarbrough	(Rahoveci) 20 pikë, 12 kërcime, 2 asistime

Simonovski, 'ylli i javës' në Superligë



Federata e Futbollit e Kosovës, së bashku me sponsoren e Superligës, Bankën Kombëtare Tregtare, BKT Kosova, vazhdojnë ta japin çmimin "Ylli i javës" për lojtarin më të mirë të xhiros. "Ylli i javës" për xhiron e 17 në BKT Superligë është shpallur futbollisti

në radhët e Drita FC, Marko Simonovski. "Sulmuesi i bardhekaltërve ishte përcaktues në fitoren që skuadra e tij e realizoi si mysafire në stadiumin 'Fadil Vokrri' kundër FC Prishtina me rezultat 1-0. Ai shënoi golin e vetëm në këtë ndeshje, duke ia sjell

tri pikë të rëndësishme skuadrës së tij", thuhet në njoftimin e FFK-së. Simonovski po kalon një formë të shkëlqyeshme te skuadra gjilanase, me gjithsej 5 gola të shënuara dhe 2 asistime në këtë edicion të BKT Superligës. Me këtë fitore FC Drita e ka ruajtur hapin

me dy skuadrat e kreut të renditjes dhe aktualisht ndodhet në pozitën e 3-të në BKT Superligë me vetëm 2 pikë më pak se lideri FC Ballkani. Çmimin "Ylli i javës" për sulmuesin e FC Dritës e dha Ilmi Alili, drejtor i degës kryesore i BKT-së.

Hamiltoni akuzon Verstappenin: I çmendur, nuk garohet kështu në Formula 1

LONDËR, 6 DHJETOR - Piloti Lewis Hamilton nuk i ka kursyer akuzat ndaj rivalit të tij për titull Max Verstappen, pas triumfit në garën e zhvilluar në pistën qytetase të Jeddas. Piloti

britanik i Mercedesit ka qenë i pakënaqur nga mënyra e pilotimit të holandezit të Red Bull. Madje dy pilotët patën edhe një kontakt gjatë garës, me Hamiltonin që e akuzoi: "Ai

është një i çmendur". "Nuk pilotohet në këtë mënyrë, pasi rrezikojmë shumë. Ajo mënyrë pilotimi nuk i përket Formulës 1. Jam dakord që në pistë po bëhet një betejë e

fortë për titullin, por duke respektuar rregullat. Gjithsesi, jam gjithnjë unë ai që shmangem për ta evituar kontaktin në garë", ka shtuar Hamiltoni.



Utah Jazzi siguron fitoren në sekondën e fundit

CLEVELAND, 6 DHJETOR - Utah Jazzi ngjitet në vendin e tretë në Konferencën e Perëndimit pas fitores në sekondat e fundit ndaj Clevelandit me shifrat 109-108. Mitchell me

35 pikë ishte lider në fushë për Jazzin. Jashtë fushës fiton edhe Charlotte, që mposhti 130-127 Atlantan (Bridges 32 pikë e Kelly 28), ndërsa Toronto mundi 102-90

Washingtonin (Siakam 31 pikë). Fitore të merituar korri skuadra e Houstonit, 118-108 ndaj New Orleansit, ndeshje ku u dallua (Wood e Gordon nga 23 pikë secili).

Rezultatet: Cleveland-Utah Jazz (108-109), Atlanta-Charlotte (127-130), Toronto-Washington (102-90), Houston-New Orleans (118-108).



Rangnick: Jam i kënaqur me punën e Ronaldos. Ishte për t'i hequr kapelën

MANCHESTER, 6 DHJETOR - Ralf Rangnick e nisi në mënyrën më të mirë të mundshme aventurën e tij në krye të Manchester Unitedit teksa "Djajtë e Kuq" triumfuan në shtëpi me rezultatin 1-0 ndaj Crystal Palaces. Vendimtar ishte goli në fraksionin e dytë të lojës (minutën e 77) nga ana e mesfushorit Fred, i cili realizoi gol mjaft të bukur me një goditje nga distanca. Megjithatë, pas ndeshjes trajneri gjerman theksoi se e rëndësishme ishte që skuadra e mbajti portën të paprekur, ndërsa shtoi se i pëlqeu shumë presioni në sulm teksa lavdëroi Cristiano Ronaldon. "Unë jam shumë i lumtur me atë se çfarë prodhoi skuadra në fushë, sidomos me 30-minutat e pjesës së parë, ku mbajtëm presingun lart. Mënyra si mbrojtëm na bëri ta kishim



kontrollin e të gjithë ndeshjes dhe ruajtja e portës paprekur ishte pjesa më e rëndësishme. Ne duhet të mos pësojmë gola. Kjo është pjesa që dua ta përmirësoj, por kemi bërë vetëm një seancë stërvitore dhe jam

vërtet i impresionuar. Ne kërkuam të luanim me dy sulmues dhe jam vërtet i kënaqur nga puna e Ronaldos me lëvizjet e tij pa top. Ishte për t'i hequr kapelën", u shpreh Rangnick.

Presidenti i UFC-s: Conor mezi pret të rikthehet në kafaz dhe të konkurrojë përsëri

DUBLIN, 6 DHJETOR - Conor McGregor mezi pret të rikthehet në kafaz dhe insiston që të ketë një sfidë për titullin kampion. Edhe Dana White, president i UFC-së, e pret me padurim rikthimin në kafaz të irlandezit, pasi në çdo ngjarje që ai ndeshet shitjet PPV (paguaj për ta parë) janë të larta. Irlandezi nuk ndeshet që prej korrikut të këtij viti, kur u dëmtua në këmbë dhe u detyrua të operohet. Ai pritet të rikthehet në kafaz në prill të 2022-shit. "Conor mezi pret të rikthehet në kafaz dhe të konkurrojë përsëri, por do t'i duhet pak kohë sa të rikuperohet nga dëmtimi", ka thënë Dana White. "Mendoj se prilli do të jetë afati i duhur për ta parë sërish në



aksion. Rëndësi ka që ai të ndeshet, por nuk di të them nëse do të ndeshet për titull apo jo", u

shpreh numri një i arteve marciale mikse, aktualisht në karantinë, pasi është infektuar me Covid-19.

SHKURT

Galatasaray në garë për Muriqin

Sulmuesi Vedat Muriqi mund të largohet nga Lazio në afatin kalimtar të janarit. Skuadra e fundit që ka hyrë në garë për sulmuesin shtatlartë është Galatasaray, e cila do të jetë rivale e Fenerbahçes për reprezentuesin "dardan". Sulmuesi nuk po arrin të gjejë vend në formacionin e trajnerit Maurizio Sarri, prandaj mundësia e largimit nga Lazio është e madhe. Muriqi ishte transferuar nga Fenerbahçes për 20 milionë euro, por vlera e tij ka rënë për 10 milionë euro.

St Etienne shkarkon trajnerin Puel

St Etienne ka shkarkuar trajnerin Claude Puel pas humbjes së thellë 5-0 kundër Rennesit. Një humbje që nuk është pranuar lehtë nga drejtuesit e klubit të cilët kanë vendosur ta ndërpresin marrëveshjen me trajnerin e tyre. Puel është trajneri i parë në Ligën 1, që shkarkohet në këtë sezon, i cili ka drejtuar ekipin e St Etienne për dy vjet. Rezultatet negative janë arsyeja e këtij vendimi, me skuadrën që ka arritur të grumbullojë 12 pikë në 17 ndeshje të zhvilluara deri tani në kampionatin francez, duke u renditur në fund të tabelës së Ligës 1 që ka sjellë shkarkimin e teknikut.

Interi, gati të 'blindojë' Inzaghin

Simone Inzaghit i kanë mjaftuar pak muaj tek Interi për të treguar se klubi ka bërë zgjedhjen e duhur duke i besuar atij pas largimit të Antonio Contes. Ish-trajneri i Lazios po drejton skuadrën me shumë sukses duke mbajtur në kreun e renditjes edhe pse janë larguar lojtarë të rëndësishëm si Lukaku dhe Hakimi. Sipas "La Gazzetta dello Sport", klubi është aq i kënaqur me trajnerin, sa po mendon që tani që t'i rinovojë kontratën që nënshkroi në verë. Zikaltrit kanë mbetur shumë të kënaqur nga puna që po bën tekniku, mënyra se si stërvitet dhe loja me gola që po tregon skuadra. Ndaj do të propozohet që në javët e ardhshme të negociohet rinovimi i kontratës së trajnerit italian e cila skadon në vitin 2023. Klubi tashmë është i gatshëm ta çojë kontratën deri në vitin 2025, duke i rritur rrogën nga 4 milionë euro në sezon, në 6 milionë euro në sezon.

Mbappe: Çfarë do që të ndodhë, unë do të luaj për një klub të madh

Sulmuesi i PSG-së, Kylian Mbappe, ka dhënë disa hollësi për të ardhmen e tij. 22-vjeçari foli për "PvSPORTFR". Ai pranoi se do të luajë për një klub të madh. "Nuk është e lehtë. Çfarë do që të ndodhë, unë do të luaj për një klub të madh. Njerëzit më pyesin nëse isha shumë i zhgënjyer. Po, kështu ishte në fillim, ngaqë doja largimin, mirëpo nuk isha në divizionin e tretë", ka thënë Mbappe.

Nga vera e kaluar raportohet se francezi do t'i bashkohet Real Madridit, që ëndërron ta sjellë në verë e ardhshme si agjent i lirë. Ndërkohë, ka raportime se Reali do të bëjë një ofertë për Mbappen edhe në afatin kalimtar të janarit.

Kujtojmë se PSG-ja refuzoi tri oferta të Real Madridit në verë në vlerë 180 milionë euro. Mbappe ka kontratë të vlefshme me PSG-në deri në qershor të vitit 2022.

Messi: Kurrë nuk kam menduar e as përpjekur për të qenë më i miri

Lionel Messi cilësohet lojtari më i mirë në botë. Sulmuesi i PSG-së fitoi për herë të shtatë në karrierën e tij "Topin e Artë" si asnjë lojtar tjetër duke treguar se është futbolli më i mirë në botë. Ish-sulmuesi i Barcelonës, në një intervistë

për "Francë Futboll", tregon se asnjëherë nuk e ka menduar se ai është më i mirë, por gjithmonë ka luftuar për ëndrrat e tij. "Unë kurrë nuk kam thënë, nuk kam menduar, apo as nuk jam përpjekur të pajtohem me

këtë ide [për të qenë më i miri]. Për mua është më se e mjaftueshme të konsiderohem apo të citohem si një nga lojtarët më të mirë në botë. Është diçka që nuk do të kisha guxuar kurrë ta imagjinoja apo ëndërroja. Nuk ndryshon asgjë

për mua të jem më i miri apo jo. Dhe kurrë nuk u përpoqa të jem", ka thënë Messi. "Nuk e di nëse jam model që duhet ndjekur. Nuk më pëlqen të jem një i tillë apo të jap këshilla. Kam luftuar për ëndrrat e mia. Në fillim ishte të isha lojtar

profesionist, më pas u përpoqa ta kaloj veten dhe të arrij objektiva të reja çdo vit. Në mes të gjithë kësaj, ka edhe një element fati. Kjo, gjithashtu, varet nga Zoti dhe besoj se ai zgjodhi që të më ndodhte e gjithë kjo", ka deklaruar Messi.



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2021:000272
 Datë: 08.11.2021
 Numri i dokumentit: 02373065

C.nr.606/20

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Besmir Juniku, me bashkëpunëtorin profesional Armond Omega, në çështjen juridike të paditësit Arton Morina nga fshati Ratkoc – Komuna e Rahovecit, të cilin me autorizim e përfaqëson av.Sefer Morina nga Prizreni, kundër të paditurës Yvonne Suzanne Rochat Ademaj nga Zvicra, për shkak të zgjidhjes së martesës me shkurorëzim, me datë 08.11.2021, merr këtë:

A K T V E N D I M

I. Të paditurës Yvonne Suzanne Rochat Ademaj nga Zvicra, tani me adresë të panjohur, **I CAKTOHET** përfaqësuesi i përkohshëm avokati **Myhedin Bekeri** nga Rahoveci.

II. Përfaqësuesi i përkohshëm në këtë procedurë konform nenit 82 të LPK-së i ka të gjitha të drejtat dhe obligimet e përfaqësuesit ligjor. Këto të drejta dhe obligime përfaqësuesi i përkohshëm do ti kryejë derisa e paditura nuk paraqitet në gjykatë, respektivisht kur Organi i Kujdestarisë e njofton gjykatën për caktimin e kujdestarit.

III. Aktvendimi do të shpallet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në një nga gazetat e përditshme ditore, në tabelën e shpalljeve të Gjykatës, si dhe një kopje do të i dërgohet Organit të Kujdestarisë të QPS-së, në Rahovec.

A r s y e t i m

Paditësi Arton Morina nga fshati Ratkoc – Komuna e Rahovecit, të cilin me autorizim e përfaqëson av.Sefer Morina nga Prizreni, ka parashtruar padi kundër të paditurës Yvonne Suzanne Rochat Ademaj nga Zvicra, tani me adresë të panjohur, për zgjidhjen e martesës.

Gjykata me datë 19.10.2020 ka caktuar seancën e shqyrtimit përgatitor, në të cilën e ka obliguar palën aktive në procedurë që në afat prej 3 ditësh ta sigurojë adresën e saktë të të paditurës. Pala aktive në procedurë përmes përfaqësuesit të autorizuar ka deklaruar se të paditurës nuk mund të ja sigurojë adresën, për shkak se e njëjta jeton jashtë shtetit dhe nuk i dihet adresa, duke i propozuar gjykatës që konform nenit 79 par.3 të LPK-së ti caktojë përfaqësues të përkohshëm.



Numri i lëndës: 2021:000272
 Datë: 08.11.2021
 Numri i dokumentit: 02373065

Gjykata me aktvendimin procedural të datës 19.10.2021 ka obliguar palën aktive në procedurë, që në afat prej 7 ditësh, të deponojë shumën prej 500 (pesëqind) Euro, në emër të shpenzimeve eventuale lidhur me caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm.

Andaj, gjykata gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 79.3 të LPK-së, për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm të të paditurës së lartëcekur.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, m
 C.nr.606/20 të datës 08.11.2021



Gjyqtari
 Besmir Juniku

KËSHILLË JURIDIKE: kundër këtij aktvendimi të gjykatës të bëhet ankesa në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit. Ankesa ushtrohet përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit, Divizioni Civil në Prishtinë.

2021: 000273

REPUBLIC OF KOSOVO
 BASIC COURT OF GJAKOVA - BRANCH OF THE COURT OF RAHOVEC

Subject number: 2021: 000272
 Date: 08.11.2021
 Document number: 02373065

C.no.606/20

BASIC COURT OF GJAKO - RAHOVEC BRANCH, General Department, Civil Division, Judge Besmir Juniku, with professional collaborator Armond Omega, in the legal case of the plaintiff Arton Morina from the village of Ratkoc - Municipality of Rahovec, which is authorized by the lawyer Sefer Morina from Prizren, against the respondent Yvonne Suzanne Rochat Ademaj from Switzerland, due to the dissolution of the marriage by divorce, on date 08.11.2021, took this:

ACT DECISION

I. To the defendant Yvonne Suzanne Rochat Ademaj from Switzerland, now with unknown address, The temporary representative lawyer Myhedin Bekeri from Rahovec is APPOINTED.

II. Temporary representative in this procedure conform article 82 of the LCP has all the rights and obligations of a legal representative. These rights and obligations will be exercised by the temporary representative until the respondent appears in court, respectively when the Custodian Body notifies the court of the appointment of the custodian.

III. The decision will be published in the Official Gazette of the Republic of Kosovo, in one of the daily dailies, in the notice board of the Court, as well as a copy will be sent to the Custodian Body of the CSW, in Rahovec

Reasoning

Plaintiff Arton Morina from the village of Ratkoc - Municipality of Rahovec, which is authorized by the lawyer Sefer Morina from Prizren, has filed a lawsuit against the defendant Yvonne Suzanne Rochat Ademaj from Switzerland, now with unknown address, for the dissolution of the marriage.

Court on dated 19.10.2020 has scheduled the preparatory review session, in which he obliged the active party in the procedure to provide the correct address of the respondent within 3 days. The active party in the procedure through the authorized representative has stated that he cannot provide the address to the respondent, because she lives abroad and her address is unknown, proposing to the court that in accordance with article 79 par.3 of the LCP to appoint temporary representatives.

Subject number: 2021: 000272
 Date: 08.11.2021
 Document number: 02373065

The court with the procedural decision dated 19.10.2021 has obliged the active party in the procedure, within 7 days, to deposit the amount of 500 (five hundred) Euro, on behalf of eventual expenses related to the appointment of the temporary representative.

Therefore, the court found that the conditions from level 79.3 of the LCP were met, for the appointment of the temporary representative of the above respondent. From what was said above,

was localized as in the enacting clause of this act decision

BASIC COURT OF GJAKOVA – BRANCH NO. RAHOVEC,
 m C.no.606 / 20 of date 08.11.2021

Judge
 Besmir Juniku
 /Signature/

LEGAL ADVICE

against this Act decision I is allowed this ruling within 15 days, from the day of accepting. The appeal is filed through this court, Through the Court of Appeals, Civil Division in Prishtinë

Prizren, 12/11/2021

I attest by my signature below that I have translated the document from Albanian to English accurately to the best of my professional ability, Refki O Avdaj, E-mail : refkiavdaj@gmail.com Tel: +377 (0) 44 169 654 ; +386 (0) 49 169 654





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
OIK



**Oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës
Komora medicinskoh sestrara, babica i ostalih zdravstvenih struĉnjaka Kosova
The Kosovo Chamber of nurses, midë ives and other health professional**

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave për Themelimin e Marrëdhënies së Punës në Sektorin Publik. Në bazë të nenit 20 pika 1.6 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor Nr.04/L-150, nenit 23 pika 1.6 të Statutit të OIK-ut, dhe duke u mbështetur në Rregulloren Organizimi i Shërbimit Profesional dhe Administrativ të OIK me Nr.Prof.765 të datës 30.09.2021, OIK shpallë këtë:

KONKURS

Për këtë pozitë të punës:

I. Titulli i vendit të punës: Zyrtar për Financa

Norma e punës: Orar i plotë (40 orë pune në javë)
Kontrata: Me periudhë të caktuar kohore
Raportoni: Kryetari të OIK-ut
Nr. i zyrtarëve: Një (1) Pozitë.

Përshkrimi i detyrave të punës:

- Harton e planin financiar dhe buxhetor të OIK-ut
- Përkujdeset për inkasimin e anëtarësisë, dhe realizimin e faturimit,
- Harton raporte financiare për nevoja të kryetarit dhe organeve të OIK;
- Harton dhe menaxhon planin e prokurimit,
- Të koordinoj dhe të udhëheq punët e kontabilitetit dhe të kujdeset lidhur me aplikimin e drejtë të dispozitave materiale – financiare;
- Të bëjë llogaritjen e të ardhurave personale të punëtorëve të OIK
- Të mbajë evidencën për pasurinë e paluajtshme, pajisjet dhe inventarin e imët të OIK;
- Të përpiloj dhe të dorëzojë raportet e nevojshme financiare sipas Ligjit;
- Të merret me furnizim me materiale dhe realizimin e pagesave;
- Të bëjë pagesat dhe arkëtimet e shpenzimeve të rrugës dhe ushqimit në vend dhe në botën e jashtme për anëtarët e OIK-ut dhe punëtorët e shërbimit profesional të OIK-ut;
- Të pranoj dhe likuidoj dokumentacionin e tërësishëm për pagesë dhe llogaritje siç janë: faturat për shpenzimet komunale, faturat e energjisë elektrike, të ujit, ngrohjes qendrore, higjienës etj;
- Të mbajë evidencën e nevojshme të shpenzimeve financiare;
- Të kryej edhe punë të tjera profesionale lidhur me çështjet financiare në bazë urdhrit të eprorit të drejtpërdrejtë, Kryetarit dhe Sekretarit të Përgjithshëm të OIK-ut;
- Të raportoj me shkrim në baza javore të Sekretari i përgjithshëm, mbi të hyrat, të dalat dhe obligimet e OIK-ut

Shkollimi i kërkuar:

- ✓ Diploma e Fakultetit Universitar
- ✓ 2 (dy) vite përvojë pune.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- ✓ Diploma e Fakultetit Universitar
- ✓ Dokumenti i identifikimit (Letërnjoftimi) kopje.
- ✓ Dëshmi për përvojën e punës.

Aftësitë / përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen:

- ✓ Të ketë shkathtësi të dëshmuara dhe efektive të komunikimit me shkrim dhe me gojë,
- ✓ Të ketë njohuri të gjuhëve zyrtare në përdorim;
- ✓ Njohja e punës me kompjuter është e domosdoshme.

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurës:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, si dhe të ketë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

Procedurat e konkurrimit: Konkurrimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Data e mbylljes së konkursit: 15 ditë nga data e publikimit në mjetet e informimit.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacionet merren, plotësohet, dhe dorëzohen çdo ditë pune nga ora 09:00-14:00 në zyrën e OIK-ut.

Adresa: Rruga "Holger Pedersen" mbrapa QKUK-së kompleksi banesor Vëllezërit Asllani.

Të gjitha dokumentet dhe dëshmitë profesionale t'i bashkëngjiten aplikacionit.

Aplikacionet e dërguara pas datës së mbylljes së konkursit dhe kërkesat e pa kompletuara nuk do të pranohen.

Kandidatët të cilët aplikojnë, të ofrojnë dëshmitë sipas konkursit të shpallur, për ndryshe kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e konkursit nuk do të thirren për intervistim.

Prishtinë,
Datë: 06.12.2021

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Qamil Sadiku nga Nivokazi, Komuna e Gjakovës shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.

► Lorik Duraku nga Demjani, Komuna e Gjakovës, shpall të pavlefshme dëftesën e plotë SH.F.M.U. "Durak Ahmeti" në Demjan nga Kl. I deri V dhe VI-IX.

► Mimoza Menxhiqi shpall të pavlefshme ID-kartelën e lëshuar nga FSSHK-ja. (Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës).

► Dhurata Selimi shpall të pavlefshme diplomën e Bachelorit të Fakultetit Filologjik në UP, dega Gjuhë dhe Letërsi Gjermane.

► Petrit Këpuska Gjakovë, shpall të pavlefshme diplomën e SH. M të Veterinarisë "Hysni Zajmi".

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit me qira. Lokali është i pasitur me të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

